

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Durres, sot me date 19.11.2019 (dymije e nentembedhete), prane selise se Shoqerise "ILLYRIAN BLOODLINE", me zyre te ndodhur ne Durres, Lagja 13 ,Plazh,Rruga Pavaresia u paraqiten personalisht si me poshte:

Zj. Anisa Rajku shtetase shqiptare lindur ne Durres me date 31.05.1990 mbajtes i pasaportes me Nr.BD2684817 madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar (ne kete kontrate referuar si "**Shitesi**").

dhe

Z. Rigels Rajku, shtetas shqiptar, lindur ne Durres me date 27.09.1986 mbajtes kartes se identitetit nr 027922900 dhe nr.personal I60927068G , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (ne kete kontrate referuar si "**Bleresi**");

MEQENESE

- A. Shitesi eshte ortak i shoqerise "ILLYRIAN BLOODLINE", nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar regjistruar me date 15.02.2019 prane Qendres Kombetare te Biznesitme numer identifikimi NUIS L91501504M (ketu e me poshte e quajtur "ILLYRIAN BLOODLINE") kapitali i te ciles eshte 100,000 leke (njqind mije).
- B. Shitesi zoteron 100% te kapitalit te "ILLYRIAN BLOODLINE.", me vlere te kapitalit 100.000 Leke
- C. Shitesi deshiron te shese tek Bleresi , **Z Rigels Rajku** 60 % te kuotes/kuoten qe zoteron tek shoqeria "ILLYRIAN BLOODLINE" ne vleren 60.000 Leke.

PER SA ME SIPER, duke marre parasysh marreveshjet reciproke te permbajtura ne kete akt, palet bien dakord per sa vijon:

NENI 1

BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE

Sipas dispozitave te kesaj Kontrate, **Shitesi** nepermjet ketij akti shet dhe **Bleresi** blen kuoten/kuoten qe zoteron tek shoqeria "ILLYRIAN BLOODLINE", qe perfaqeson 60 % te kapitalit te "ILLYRIAN BLOODLINE" me vlere 60,000 leke, duke arritur keshtu kuoten 60 % te kapitalit te "ILLYRIAN BLOODLINE", ne vleren 60.000 leke .

Kjo kuote blihet me cmimin e percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate

NENI 2

ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

2.1. Çmimi i blerjes se kuotes objekt i kesaj Kontrate eshte ne vleren prej 60,000 Leke, me poshte i quajtur "Çmimi i Blerjes", vlere e cila do te likujdohet nepermjet llogarise bankare.

2.2. Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar" dhe konkretisht nenin 10 ku thuhet se "Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata", palet jane dakord qe:

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Bleresi, pra **Z. Rigels Rajku** menjehere perfiton pronesine mbi Kuoten me vlere prej 60,000 leke te shoqerise "ILLYRIAN BLOODLINE".

NENI 3

DEKLARATAT DHE GARANCITE

3.1. Shitesi deklaron dhe garanton se:

- (i) nenshkrimi dhe zbatimi e kesaj kontrate eshte autorizuar rregullisht
- (ii) Shitesi ka nenshkruar dhe shlyer ne menyre te plote kuoten, objekt i kesaj Kontrate;
- (iii) kjo kuote qe transferohet eshte e lire nga çdo barre apo ndonje pretendim tjetër ligjor nga pale te treta,
- (iv) kjo Kontrate perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Shitesin.

3.2. Bleresi deklaron dhe garanton se:

- (i) nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate eshte autorizuar rregullisht
- (ii) ka te drejten, dhe nuk ka ndonje ndalim ligjor apo te ndonje lloji tjetër, per te nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj;

(iii) kjo Kontrate eshte neshkruar rregullisht dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem dhe te detyrueshem per Bleresin.

NENI 4

TE NDRYSHME

Kjo Kontrate, nenshkruhet ne 3 kopje ne gjuhen shqipe dhe perben marreveshjen e plote midis paleve.

NENI 5

LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET

5.1. Problemet ne lidhje me ceshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.

5.2. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

PALET

SHITESI

Administratori

Zj. Anisa Rajku

BLERESI

Z. Rigels Rajku


